



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/167
Datë: 22.01.2014



Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 155, 156, 157, 158, 159 dhe 160 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

 Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/167

Datë: 22.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile për vitet 2013-2017.
2. Këshilli është struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile.
3. Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile për vitet 2013-2017 në përbërjen e tij ka 29 anëtarë, nga të cilët 14 janë përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 15 përfaqësues nga shoqëria civile.
4. Nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, 14 prej tyre përzgjidhen nga vet organizatat e shoqërisë civile ndërsa 1 emërohet nga Platforma CiviKos.
5. Këshilli udhëhiqet nga:
 - 5.1. Zëvendës Kryeministri i Republikës së Kosovës, i emëruar nga Kryeministri (Kryesues)
 - 5.2. Përfaqësuesi i emëruar nga Platforma CiviKos (Bashkëkryesues)
6. Përveç Kryesuesit të Këshillit i cili emërohet nga Kryeministri, përfaqësuesit tjerë të Qeverisë emërohen nga institucionet në vijim, të cilat përfaqësohen në nivel të Ministrave ose zëvendësministrave:
 - 6.1. Ministria e Administratës Publike, një anëtarë
 - 6.2. Ministria e Integritimit Evropian, një anëtarë
 - 6.3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, një anëtarë
 - 6.4. Ministria e Financave, një anëtarë
 - 6.5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, një anëtarë

- 6.6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, një anëtarë
 - 6.7. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, një anëtarë
 - 6.8. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, një anëtarë
 - 6.9. Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit, një anëtarë
 - 6.10. Zyra për Planifikim Strategjik/Zyra e Kryeministrit, një anëtarë
 - 6.11. Zyra për Komunikim Publik, një anëtarë
 - 6.12. Sekretariati Koordinues i Qeverisë, një anëtarë
 - 6.13. Zyra Administrative/Zyra e Kryeministrit, një anëtarë
7. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit shërben si Sekretariat i Këshillit, dhe do të jetë në funksion për të zhvilluar dhe mirëmbajtur të gjitha aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit.
 8. Procesin e përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në Këshill do ta organizojë Platforma Civikos, në bashkëpunim me Sekretariatit e Këshillit, dhe në bazë të një procedure demokratike, të hapur dhe transparente.
 9. Për mbarëvajtjen dhe për një punë të suksesshme të këtij Këshilli, Sekretariati do të mbështetet nga Zyra e Kryeministrit në aspektin financiar dhe me resurse njerëzore.
 10. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit mandatohet që në bashkëpunim me Platformën CiviKos të hartojë Termat e Referencës për punën e Këshillit, të cilat do të miratohen në takimin e parë të Këshillit.
 11. Obligohet Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi.
 12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

per
Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/167

Datë: 22.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës si dhe nenit 5 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Hapësinor "Monumenti i Natyrës me rëndësi të Veçantë Ujëvarat e Mirushës"
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Planin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/167

Datë: 22.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës dhe nenit 3 të Ligjit për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" si dhe nenit 5 dhe 8, të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Hapësinor për Zonën e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë "Beteja e Koshares".
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Planin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/167

Datë: 22.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës dhe nenit 3 të Ligjit për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" si dhe nenit 5 dhe 8, të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:



V E N D I M

Për hartimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

1. Të fillohet me procesin e hartimit të Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna (tekstin e mëtejme Plani);
2. Bazë për përcaktimin e zonës së Planit është Ligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", sipas së cilit sipërfaqja e parkut është 62488 ha;
3. Gjatë procesit të hartimit të Planit do të caktohen me hollësisht kufijtë e Parkut. Arsyet për këtë veprim mund të jenë të natyrës teknike dhe të kërkesave që mund të dalin gjatë definimit të zonimit;
4. Qëllimi kryesor i hartimit të Planit është shfrytëzimi racional dhe i planifikuar i hapësirës, sipas të cilit do të ndërpritet degradimi i mëtutjeshëm i zonës së Parkut.
5. Plani duhet të ofrojë një përmbledhje të rregullave, sipas të cilave do të përcaktohet zonimi dhe kahjet e zhvillimit të ardhshëm të Parkut.
6. Bazë për hartimin e Planit janë të gjitha ligjet në fuqi që lidhen me fushën e planifikimit hapësinor dhe mjedisit.
7. Hartimi i Planit shërben si udhëzues: për identifikimin e lokacioneve me potenciale të zhvillimit hapësinor të parkut; për aprovimin e politikave për vendosjen e zhvillimeve në territorin e parkut, që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme; për identifikimin e rolit të

- vendbanimeve (fshatrave) në Park dhe përreth tij, si dhe rolin e qyteteve të mëdha që gjenden në afërsi të Parkut; dhe për identifikimin e rolit të infrastrukturës dhe lidhjeve me territorin e Parkut.
8. Plani duhet të promovoj interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për zhvillim më të shpejtë ekonomik, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës, duke respektuar në maksimum parimet e mbrojtjes për trashëgimin natyrore dhe kulturore.
 9. Bartës i procesit për hartimin e Planit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa përgjegjës për hartimin e Planit është Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës përkatësisht Instituti për Planifikim Hapësinor;
 10. Ministrinë, organizatat e veçanta, ndërmarrjet publike dhe institucionet kompetente të mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes së natyrës dhe monumenteve të kulturës, infrastrukturës, bujqësisë, pyjeve dhe ujërave, ekonomisë si dhe organizatat tjera janë të obliguara t'i dërgojnë bartësit dhe përgjegjësit të hartimit të Planit, të gjitha të dhënat të cilat i kanë në dispozicion, kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm nga fushëveprimi i tyre.
 11. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Planit.
 12. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
 13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

 Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Nr. 06/167

Datë: 22.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:

V E N D I M

1. Largohet nga pakoja tenderuese e Projektit "Kosova e Re" zhvillimi i Minierës së Sibovcit dhe shfuqizohet nën-paragrafi 2.2. i vendimit nr. 06/84 i datës 19.07.2012.
2. Obligohet Komiteti Drejtues i Projektit të zhvilloj një transaksion në pajtim me praktikat më të mira për tërheqjen e Investitorëve privat për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

 Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës


Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/167

Datë: 22.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë nr. 20/162 të datës 27 dhjetor 2013

1. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi i Qeverisë nr. 20/162 i datës 27 dhjetor 2013 si në vijim: Pikës 1. të këtij vendimi i shtohet edhe një anëtar, z. Bajram Zogiani.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me biografinë e të propozuarit t'ia procedojë për shqyrtim dhe emërim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/167

Datë: 22.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 15/158 të datës 29.11.2013

1. Vendoset regjimi i vizave për shtetasit e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe hiqet nga Lista e vendeve, shtetasit të cilët lirohen nga regjimi i vizave për hyrje, tranzit dhe qëndrim në territorin e Republikës së Kosovës deri në 90 ditë për një periudhë gjashtë mujore prej datës së hyrjes së parë, Paragrafi i I-rë-Shtojca 1. e vendimit të lartcekur.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/167

Datë: 22.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 15,000 euro (pesëmbëdhjetë mijë euro), për përkrahjen e familjes së të ndjerit Dimitrije Janiqjeviq, anëtar i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe bartën në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për procedim të mëtutjeshëm.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/167

Datë: 22.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për shënimin e gjashtë vjetorit të Pavarësisë në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues, i Zyrës së Kryeministrit, anëtar;
2. Ftohen që ta dërgojnë nga një përfaqësues në këshill:
 - 2.1. Përfaqësues, Zyra e Presidentes, anëtar;
 - 2.2. Përfaqësues, Kuvendi, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues, Komuna e Frishtinës, anëtar;
 - 2.4. Kryetarët e Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
 - 2.5. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, anëtar; dhe
 - 2.6. Përfaqësues të OJQ-ve.
3. Për punën e Këshillit Organizativ për shënimin e gjashtë vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës ndahen mjete financiare në vlerë prej 100,000.00 (njëqind mijë) euro.
4. Mjetet nga pika 3. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në Zyrën e Kryeministrit në kodin 10700.
5. Obligohet Ministra e Financave, Zyra e Kryeministrit, dhe Këshilli për zbatimin e këtij vendimi.


6. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Hashim Thaçi', is written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/167


Datë: 22.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2014, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës

1. Në Programin Legjislativ të vitit 2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës përfshihet Projektligji si në vijim:
 - 1.1. Projektligji për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (ZKM)
2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

 Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë